Me përpunimin e Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje, Qeveria e Republikës së Maqedonisë shkon në drejtim të përmbylljes së dekadës për luftë kundër kësaj të keqeje shoqërore.

Strategjia nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje paraqet dokument themelor strategjik i Republikës së Maqedonisë, i cili ka për qëllim përcaktimin e drejtimeve dhe prioriteteve strategjike për shkatërrimin dhe pengimin e këtij lloji të dhunës dhe përcaktimin e bartësve përgjegjës për zbatimin e tyre.

Strategjia është hartuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit. Po ashtu, Strategjia e përmendur është përpunuar me iniciativë dhe përkrahje të Shoqatës ESE, si dhe me pjesëmarrje të aktorëve të rëndësishëm në shtet, organizatave qeveritare dhe joqeveritare, organizatave ndërkombëtare, partnerë të rëndësishëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Me këtë është mundësuar një konsensus i gjerë për postulatet e saj themelore, që garanton implementimin e saj të suksesshëm.

Organizatave dhe qytetarëve janë aktorët kryesorë dhe partnerë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për promovimin dhe avancimin e të gjitha formave të mbrojtjes nga dhuna në familje.


PJESA E PARË

PJESA E PARË: ANALIZA E GJENDJES

1. ANALIZA LIDHUR ME PARAQITJEN E DHUNËS NË FAMILJE

Regullimi i dhunës në familje në legjislacionin pozitiv e numëron Republikën e Maqedonisë në rendin e atyre shteteve të cilat përpos ofrimit të ndihmës së obliguar adekuate të viktimës së dhunës në familje, aplikoi edhe mbrojtje juridike komplementare të viktimave të këtyre rasteve. Në vitin 2004 për herë të parë u rregullua problemi i dhunës në familje si në legjislacionin qytetar, po ashtu edhe në atë ndëshkues, me çka u siguroi harmonizim me rekomandimet dhe standardet ndërkombëtare në këtë sferë, që imponojnë aplikim të zgjidhjeve të përgjithshme ligjore, respektivisht inkriminim të dhunës në familje dhe aplikim të masave për përkohshme për mbrojtje të viktimave të dhunës.


Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka vendosur bazë të të dhënave për masat e ndërmarra të mbrojtjes për rastet e paraqitura të dhunës në familje, duke filluar prej vitit 2004 deri më sot, pasi që problemi me dhunën në familje u rregullua në mënyrë ligjore.



Grafikoni 1

Në fillim, pasi që dhuna në familje është rregulluar me ligj, ka numër më të madh të rasteve të paraqitura, që është e pritur gjatë aplikimit të rregullativës së re ligjore për tejkalimin e këtij problemi shoqëror.


Dhuna në familje, viti 2007



Grafikoni 2


Po ashtu, përkatësia nacionale e viktimave nuk është primare për paraqitjen e të njëjtës, duke pasur parasysh faktin se dhuna në familje është e pranishme në të gjitha bashkësitë etnike (Grafikoni 2).

EP Enti për veprimtari sociale gjatë vitit 2005 kreu hulumtimin¹ në të cilin ishin përfshirë gjithsej 218 familje, në të cilat kanë qenë të evidentuar viktime të dhunës në familje. Nga i njëjti hulumtim mund të vërehet se statusi socio-material i familjes në të cilën është evidentuar dhunë në familje është në nivel të ulët, por nuk është përjashtuar mundësia që kjo (pra dhuna) të paraqitet edhe te familjet me të hyra mesatare (Grafikoni 3).



Grafikoni 3

Po ashtu, në hulumtimin e kryer nga ana e EP Enti për veprimtari sociale, theks të veçantë është vënë në strukturën arsimore të viktimeve, por edhe në profesionin që e kryen viktime e dhunës në familje. Sipas shkallës së arsimit, mbisundojnë viktime që posedojnë arsimim minimal ose nuk kanë të kryer shkollë fare, ndërsa përqindja është e vogël e viktimeve që kanë shkollim të lartë apo sipëror (Grafikoni 4).



Grafikoni 4

Gjatë përgatitjes së analizës për gjendjen e dhunës në familje, janë shfrytëzuar edhe hulumtime tjera relevante në Republikën e Maqedonisë, siç është hulumtimi "Jeta nën hije", që është kryer nga Shoqata ESE në vitin 2007 (për informata më të hollësishme shiko në aneksin 1).

¹Te dhënat për këtë pjesë janë marrë prej "Hulumtim dhe analiza "EP Enti për veprimtari sociale 2007"

PJESA E PARË

Konstatimin global që e ofruan rezultatet e hulumtimit është të kuptuarit për përhapjen e gjerë të tre llojeve të dhunës ndaj femrave në hapësirat tona. Por, gjatë kësaj duhet të theksohet shkalla e ndryshme e përhapjes së llojeve të veçanta të dhunës. Është konstatuar se vëllimi më i lartë i paraqitur është te dhuna psikike - 56.4% nga të anketuarat janë deklaruar se kanë përvojë personale nga njëra nga përmbajtjet e dhunës psikike. Më pak nga të anketuarat, më saktë 17,7% prej tyre, kanë konfirmuar se kanë qenë viktimë të dhunës fizike, kurse më pak nga të anketuarat - 10,6%, që ishte edhe në kuadër të pritjeve, janë deklaruar se u është prishur integriteti i tyre seksual.

Sa i përket këtij numri, Ministria e Punëve të Brendshme, respektivisht organet e punëve të brendshme kanë evidentuar 215 vepra penale, 1.202 shkelje dhe 3.750 ankesa për dhunë në familje në vitin 2005. Në mungesë të të dhënave për gjininë e viktimës për vitin 2005, të dhënat e vitit 2006 të të njëjtës Ministri thonë se femrat në 70,1%, kurse meshkujt 29,9% nga rastet e paraqitura paraqiten si viktimë.

Qendrat e punëve sociale, në periudhën qershor 2005 - qershor 2006 kanë evidentuar 839 raste të dhunës në familje. Në rolin e viktimave të dhunës në familje dominojnë femrat me përfaqësim 93,11%, përderisa meshkujt me 6,89% nga rastet e paraqitura që janë lajmëruar në rolin e viktimave.

Sipas statistikës zyrtare të organeve për ndjekje, me e përfaqësuar është dhuna fizike me 87%, më pas vjen dhuna psikologjike me 10,2% dhe ajo seksuale me 2,8%. Nuk ka ndonjë dallim në përfaqësimin e formave të caktuara të dhunës në familje që janë paraqitur në qendrat për punë sociale, por ekziston dallimi në lartësinë e përfaqësimit të tyre. Ashtu që në qendrat e punëve sociale dhuna fizike është e përfaqësuar me 52,43%, ajo psikologjike me 44,44%, kurse dhuna seksuale me 2,57% dhe shfrytëzimit të punës me 0,56%.

Në periudhën qershor 2005 - qershor 2006 prokuroritë themelore publike nga 276 paraqitjet penale për dhunë në familje në gjykatë kanë parashtruar 238 aktakuza. Dallimi ndërmjet fletëparaqitjeve penale të evidentuara dhe ngritjeve të aktakuzave mund të ketë të bëjë me refuzimin e paraqitjeve penale dhe tërheqjes së viktimave të dhunës në familje nga ndjekja penale, që nuk është rast vetëm me rastet e dhunës në familje. Gjykatat themelore në të njëjtin vit kanë vepruar në 311 aktakuza.

Shqiptimi i dënimeve më të lehta, respektivisht shfrytëzimi i mundësisë për lehtësimin e dënimit është karakteristike gjatë sanksionimit të sjelljes së kryerësve të dhunës në familje.

Këtë gjë e thënë të dhënat për aktgjykimet e shqiptuara për veprat penale më të pranishme për periudhën qershor 2005 - qershor 2006. Kështu, për shembull, për lëndim fizik (vepra penale më shumë e pranishme nga sfera e dhunës në familje) edhe përpos dënimit me burg të paraparë në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri më 3 vjet, vetëm në 15% të aktvendimeve të shqiptuara gjykata ka shqiptuar dënim me burg (11 raste). Dënimet me kusht, dënimet në të holla, dënimet në të holla por me kusht mbisundojnë në aktgjykimet e shqiptuara (74 aktgjykime).

Pasojat nga dhuna ndaj femrave që janë paraqitur gjatë kohës së incidentit të fundit në hulumtim, tregojnë për pasojat serioze, jo vetëm për shëndetin e viktimave, por edhe për pasojat ekonomike nga humbja dhe zvogëlimi i aftësisë për punë.

Njollat nga rrahjet (46,1%), prerjet (14,2%) dhe lëndimet nga dëmtimi me thikë (11,2%) janë pasojat më të shpeshta të dëmtimit fizik. Në 20,7% ajo te femrat rezultojnë me lëndime serioze trupore (lëndime me thikë, dëmtimi i syrit, thyerja e dhëmbëve), si rezultat i asaj se çdo e treta femër ka kërkuar ndihmë mjekësore (34,0%) është ndalur për kurim spitalor.

Frika (22,9%), humbja e vetëbesimit (16,7%), depresioni (16%) dhe pagjumësia (14,2%), janë pasojat më të shpeshta nga dhuna për shëndetin mental të femrat. Shfrytëzimi i medikamenteve, pirja e tepruar e duhanit dhe konsumimi i tepruar i ushqimit janë mekanizmat me të cilat femrat ballafaqohen me dhunën.

Paafhtësia për koncentrik është një nga pasojat më të shpeshta të dhunës mbi aftësinë për punë të viktimave, me çka pason humbja e besimit në aftësitë personale të viktimës. Në 21,1% femrat paraqesin paafhtësi për punë.

Sipas hulumtimit të përmendur (për informata më të hollësishme shiko aneksin 1) si probleme aktuale që paraqiten lidhur me dhunën në familje janë: vlera me përmbajtje patriarkale, niveli i ulët i paraqitjes në polici të dhunës në familje, niveli i ulët i paraqitjes së dhunës në qendrat për punë sociale, jo-afirmimi i organizatave joqeveritare, paraqitja e pamjaftueshme e dhunës në familje nga ana e personelit medicinal, qytetarët nuk janë të njohur sa duhet me inkriminimin e dhunës në familje, rregullimi jo i plotë ligjor dhe nënligjor i dhunës në familje, mos-mbajtja e evidencës së posaçme për rastet e dhunës në familje, mosoperativiteti i plotë dhe i pjesshëm i pjesës së masave të përkohshme të mbrojtjes, mosqasja adekuatë e strukturave profesionale në rastet e dhunës në familje dhe mosndërmarrja e aktiviteteve të vazhdueshme preventive.

1.1 BASHKËPUNIMI NDËRSEKTORIAL

Sistemi multikoordinativ i mbrojtjes akoma është në fazën e vendosjes. Në fakt, janë përgatitur protokolle për veprimin e strukturave profesionale dhe të sistemit joformal, unifikimi i praktikës pozitive, standardizimi i shërbimeve (sistemi formal dhe joformal i mbrojtjes).

1.2 GRUMBULLIMI I TË DHËNAVE

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, nëpërmjet qendrave për punë sociale në çdo tre muaj grumbullon të dhëna për paraqitjen e dhunës në familje. Të dhënat e tyre i përmbajnë këto parametra: rastet e reja të evidentuara të dhunës në familje; punë në rastet tanimë të regjistruara; rastet e kompletuara/zgjidhura; rastet e paraqitura nga institucionet/organizatat tjera; nacionaliteti; gjinia dhe moshja e viktimës; lloji i intervenimit të ndërmarrë nga ana e qendrave për punë sociale; intervenimi me polici; masat e propozuara për mbrojtje të përkohshme; numri i kërkesave të parashtruara për shqiptimin e masave të përkohshme; evidentimi i faktit se sa nga viktimat janë shfrytëzues të ndihmës sociale (ndihmës së vazhdueshme dhe asaj të njëhershme) e tjerë. Obligim për grumbullimin e të dhënave ka edhe linja nacionale SOS, e përkrahur financiarisht edhe nga ana e MPPS, e cila rregullisht e lajmëron Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për numrin e paraqitjeve dhe mbrojtjen e ofruar.

Të dhëna të përpunuara për dhunë në familje mund të merren edhe nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme që zakonisht përmbajnë statistika sa i përket veprave penale të regjistruara, vendi i ndodhjes (shkaktimit) të tyre (qyteti, rajoni ku janë paraqitur), kryerësit dhe viktimat e këtyre veprave penale. Sektori i analitikës, hulumtimit dhe dokumentimit përgatit informacioni tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujore dhe vjetore. Në fillim të vitit 2007 janë përgatitur tabela për veprat e kryera penale, si dhe tabelë për ankesat dhe shkeljet e regjistruara në lidhje me dhunën në familje dhe janë shpërndarë në të gjitha shërbimet analitike në Shërbimet e Punëve të Brendshme në territorin e Republikës së Maqedonisë.

Organet e jurisprudencës dhe prokuroritë themelore publike nuk mbajnë evidencë të posaçme për rastet e dhunës në familje.

PJESA E PARË

1.3 EDUKIMI I STRUKTURAVE PROFESIONALE

Edukim të vazhdueshëm profesional dhe aplikim të përmbajtjeve edukative, që do të thotë studim i tërësishëm i dhunës në familje në institucionet arsimore të mesme dhe sipërore, nuk ka. Për lëvdatë janë disa iniciativa të caktuara të institucioneve arsimore, që i ndërmarrin hapat iniciativë në këtë sferë, siç është Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë, të cilët aplikuan përmbajtje mësimore për edukimin fillestar dhe të vazhdueshëm sa i përket kësaj çështjeje.

Rëndësi jo më të vogël për kuptimin e drejt dhe për zhvillimin e praktikës pozitive në qasjen e rasteve të dhunës në familje i ka kushtuar edhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në përpjekjet e saj për edukimin e kuadrove të saj në këtë sferë dhe, ajo që është më e rëndësishme edukim për nevojën e qasjes së obliguar multikoordinative. Gjatë vitit 2004 dhe 2005 janë stërvitur 86 persona profesionalë nga qendrat për punë sociale, nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, organet e ndjekjes dhe përfaqësues të sektorit joqeveritar për punë me viktimat e dhunës në familje.

Gjatë vitit 2006 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale e vazhdoi bashkëpunimin me Zyrën e UNICEF-it në Shkup. U zbatua trajnimi i 13 stërvitësve për dhunë në familje për edukim të mëtutjeshëm të personave profesionalë nga institucionet dhe sektori joqeveritar.

Në fund të vitit 2007 stërvitësit realizuan 7 seminare në 7 komuna, që u përfshinë rreth 200 persona profesionalë në kuadër të trajnimit: "Punë me viktimat e dhunës në familje në bashkësinë lokale".

1.4 AKTIVITETET PREVENTIVE

Aktivitetet preventive realizohen duke organizuar fushata, që tradicionalisht organizohen që një dekadë në kuadër të 16 Ditëve Ndërkombëtare të aktiviteteve në luftën kundër dhunës ndaj femrave të Kombeve të Bashkuara. Duke filluar që nga qershori i vitit 2005 Republika e Maqedonisë në mënyrë aktive është përfshirë në shënimin e Fushatës panevropiane në luftën kundër dhunës në familje, që është në kuadër të Këshillit të Evropës.

Po ashtu, në vitet e kaluara janë realizuar shumë fushata nacionale për bashkëpunim ndërinstitucional për ballafaqimin me dhunën në familje, të cilat në të njëjtën kohë ishin të përkrahura nga ana e medimeve për ngritjen e vetëdijes njerëzore.

1.5 INICIATIVA PËR AVANCIMIN E EFIKASITETIT NË ZBATIMIN E STRATEGJISË

Prej pavarësisht të Republikës së Maqedonisë deri më sot institucionet qeveritare në bashkëpunim me sektorin joqeveritar kanë filluar intensivisht të punojnë në sferën e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna në familje, në ndihmën dhe përkrahjen e viktimave, si dhe në plotësimin dhe ndryshimin e rregullativës ligjore dhe harmonizimin e të njëjtës me standardet e BE-së.

Përgatitja e protokolleve për qasjen e strukturave profesionale dhe pjesa e sistemit të mbrojtjes joformale (Linja nacionale SOS, qendrat e krizave dhe strehimoret), standardizimi i shërbimeve që sistemi i mbrojtjes i siguron, avancimi i efikasitetit të sistemit juridiko-qytetar dhe juridiko-ndëshkues janë një ndër iniciativat më të rëndësishme që kushtëzojnë dhe garantojnë rritje të efikasitetit të të gjitha institucioneve/organizatave që punojnë në këtë sferë.

Është përfundim i përgjithshëm se nga të gjitha strukturat profesionale relevante, Ministria e Arsimit dhe Shkencës është më pak e përfshirë në ndërmarrjen e disa llojeve të aktiviteteve në sferën e mbrojtjes nga dhuna në familje. Aktivitetet e ndërmarra në këtë sferë janë në bazë ad hock me inkuadrimin e shkollave të caktuara në projekte që janë iniciuar nga organizatat e qytetarëve. Kuadri arsimor nuk ka kaluar asnjë edukim të sistemuar sa i përket dhunës në familje të nxënësit, në drejtim të punës me to dhe paraqitjes së dhunës. Situata është akoma më alarmante nëse e dimë se mungesat e përmendura më lartë po zgjerohen edhe në sferën e programeve dhe përmbajtjeve arsimore nëpërmjet përfaqësimit të qëndrimeve tradicionale dhe vlerave patriarkale, që janë shkaqet kryesore për paraqitjen dhe ekzistimin e dhunës në familje.

Në nivel të dokumenteve, të cilat në njëfarë mënyre e rregullojnë çështjen e dhunës në familje, vlen të theksohet se:

- Plani nacional për aksion për barazi gjinore, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në maj të vitit 2007 parashikon shumë sfera strategjike, ndërmjet të cilave edhe: "Femra dhe dhuna". Ky dokument dhe përmbajtja e këtij dokumenti i paraparë për sferën e përmendur strategjike ishte marrë parasysh gjatë përgatitjes së Strategjisë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje.

Njëherësh, është miratuar edhe Deklarata për luftë kundër dhunës ndaj femrave, duke përfshirë këtu edhe dhunën në familje - e miratuar nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë (nëntor, viti 2006). Me këtë deklaratë për herë të parë Republika e Maqedonisë, përpos pushtetit ekzekutiv, për këtë çështje u zotua edhe Parlamenti.

PJESA E DYTË: FAKTORËT E RREZIKUT PËR PARAQITJEN E FENOMENIT TË DHUNËS NË FAMILJE

2.1 FAKTORËT INDIVIDUALË DHE SHOQËRORE

Individi mund jetë viktimë e dhunës në familje gjatë tërë jetës së tij, që nga fëmijëria e hershme deri në pleqërinë e thellë. Zakonisht viktima të dhunës janë femrat, fëmijët dhe personat e moshuar.

Hulumtimet e shumta që janë kryer në nivel ndërkombëtar dhe nacional tregojnë se janë përcaktuar disa grupe të faktorëve, individuale dhe shoqërore, që janë të lidhur dhe që plotësohen në ndikimin e paraqitjes së dhunës në familje.

1. Dhuna në familje zakonisht ka një kornizë të gjerë të sjelljes, ku një anëtar (apo më shumë) e aplikon që të ushtrorë forcë apo kontroll ndaj anëtarëve tjerë të familjes, respektivisht t'i plotësojë nevojat e tij në dëm të anëtarit tjetër. Pikërisht për këtë shkak çdo rast individual paraqet shkelje të të drejtave njerëzore.
2. Individët që janë viktimë e dhunës janë në numër të madh dhe ndikojnë në shëndetin mental dhe fizik, sikurse ata që janë viktima të drejtpërdrejta, po ashtu edhe te ata që janë mbikëqyrës. Pasojat më të shpeshta nga dhuna janë vetëbesimi i ulët, depresioni, agresioni, tentime për vetëvrasje, funksionim i dobët në vendin e punës, në shkollë, disfunkcionet seksuale, sëmundjet bartëse seksuale, shtatzënia e padëshiruar dhe tjera.
3. Ekziston transmetim transgjeneratash në shembullin e dhunës në familje. Konsiderohet se sasia e dhunës së përjetuar në fëmijëri kontribuon në zhvillimin e dhunës në konfliktet ndër-njerëzore në periudhën që pason pas fëmijërisë.

4. Fëmijët janë grupi më i ndjeshëm kur bëhet fjalë për dhunën në familje, sepse zhvillimi bio-psikosocial është drejtpërdrejt nën ndikimin e shembullit të marrëdhënieve familjare dhe ka pasoja të mëdha në strukturën e personalitetit dhe në zhvillimin e problemeve mentale-shëndetësore gjatë ciklit të jetës.

5. Ekziston një lidhshmëri ndërmjet pranisë së dhunës në familje dhe sasisë së dhunës në shoqëri, duke përfshirë këtu edhe dhunën që prezantohet në medime.

Dhuna në familje mund të definohet si një sjellje interaktive të një numri më të madh të kryerësve, të cilët mund të grupohen në tri nivele: ato përfshijnë karakteristikat individuale, familjare dhe shoqërore.

Karakteristikat individuale e përfshijnë karakterin e personalitetit, pamjet e tij/saj për jetën, për vlerat, besimin etj.

Karakteristikat familjare e përfshijnë dinamikën, rolin dhe format e sjelljes në raportet me partnerët dhe me të gjithë, nga anëtari më i ri deri të anëtari më i moshuar i familjes.

Karakteristika socio-kulturore përfshin gjendjen dhe marrëdhëniet shoqërore, normat, ligjin dhe praktikën në sistemin e jurisprudence dhe ngjashëm. Posaçërisht rëndësi të madhe ka interaksioni i individit në rethin social, streset sociale që janë të lidhura me papunësinë, pasigurinë ekonomike, mosveprimi i jurisprudence dhe ngjashëm që ndikojnë për dhunë në familje. Po ashtu, ka të bëjë edhe me normat, vlerat dhe stereotipin në jetën familjare, qëndrimi tolerant ndaj dhunës dhe pranimi i dhunës në shoqëri, si dhe qëndrimet ndaj barazisë, drejtësisë dhe ngjashëm.

2.2 PËRPARËSITË, MUNGESAT, MUNDËSITË DHE RREZIQET

Nëpërmjet analizës së dobësive dhe përparësive, mund të hetohen faktorët pozitiv dhe negativ që ndikojnë në realizimin e drejtimeve (rrugëve) dhe përcaktimeve për luftë kundër dhunës në familje. Kjo analizë ndihmon, gjithashtu, të shihen masat që duhet të ndërmerren për vendosjen e baraspeshës ndërmjet përparësive dhe mundësive të jashtme.

PËRPARËSITË

- Baza juridike e vendosur për trajtimin e dhunës në familje
- Ekzistimi i resurseve për avancimin e mbrojtjes dhe parandalimi nga dhuna në familje
- Përforsimi i resurseve njerëzore nëpërmjet edukimit adekuat të personave profesionalë për punë me viktime të dhunës në familje
- Reformat e filluara në një numër të madh të sektorëve dhe vendosja e bashkëpunimit ndër-sektorial dhe ndërministror
- Aktivitetet e ndërmarra për ngritjen e vetëdijes njerëzore sa i përket dhunës në familje

DOBËSITË

- Ekzistimi i sistemit patriarkal i vlerave për martesën dhe familjen
- Niveli jo i kënaqshëm i paraqitjes së rasteve të dhunës në familje
- Informim jo i mjaftueshëm i publikut (masës) për kompetencat e institucioneve për ndërmarrjen e masave të mbrojtjes
- Afirmim i pamjaftueshëm për aktivitetet e sektorit joqeveritar
- Edukim i pamjaftueshëm i personave profesionalë që punojnë me viktime të dhunës në familje
- Informim i pamjaftueshëm i publikut për mbrojtjen juridike penale
- Mosekzistimi i sistemit gjithëpërfshirës për evidencë
- Kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve për ndërmarrjen e masave për mbrojtje
- Mosvendosja e mekanizmit për veprim sistematik
- Mosekzistimi në vazhdimësi për aktivitetet parandaluese

PJESA E TRETË

PJESA E TRETË: KORNIZA JURIDIKE PËR RREGULLIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

3.1 LEGJISLACIONI NDËSHKUES

Dhuna në familje është inkriminuar në kuadër të veprave penale ekzistuese në legjislacionin ndëshkues. Prej këtu, legjislacioni ynë - me definimin, dënimet e ashpra të parapara dhe ndjekja sipas detyrës zyrtare - shkon një hap më përpara. Në fakt, dhuna në familje ndahet si një lloj i veçantë i krimit. Aq më tepër sa veprat penale për dhunën në familje në Kodin Penal nuk janë pjesë e veprave penale për mbrojtje të martesës dhe familjes. Karakteristika pozitive e zgjidhjeve tona normative është lidhshmëria e dy sistemeve - atij qytetar-juridik dhe ndëshkues-juridik - që është në pajtim me standardet ndërkombëtare, që, me fjalë të tjera, inkriminimi nuk e përjashton shfrytëzimin e masave të përkohshme të mbrojtjes, por edhe anasjelltas.

Në Kodin Penal² të Republikës së Maqedonisë dhuna në familje nënkuptim maltretim, ofendim i rëndë, kërcënim i sigurisë, dëmtim fizik, dhunë seksuale apo psikologjike ose dhunë fizike, me të cilën shkaktohet ndjenja e pasigurisë, kërcënimit apo frikës, ndaj bashkëshortit/bashkëshortes, prindërit, apo fëmijëve ose personave tjerë që jetën në bashkësi martesore apo jashtë saj ose në amvisëri të përbashkët, si dhe ndaj ish burrit/gruas ose të personave që kanë fëmijë të përbashkët apo ndodhen në marrëdhënie të ngushta personale.

Me veprat penale kundër jetës dhe trupit, janë të sanksionuara heqja e të drejtës për jetë, dëmtimi apo shkatërrimi i integritetit fizik, ose shkaktimi të dhimbjes fizike ose shpirtërore (dëmtimi fizik dhe dëmtimi i rëndë fizik), respektivisht forma fizike e dhunës. Nëpërmjet veprave penale të detyrimit, heqja e lirisë dhe kërcënimi ndaj sigurisë, sanksionohet nëpërmjet veprave penale përdhunimi, sulmi seksual ndaj personit të pamundur, sulmi seksual ndaj fëmijës dhe ndërmjetësimi në kryerjen e prostitucionit.

Me reformat në legjislacion, posaçërisht ato që janë të sferës familjare, të vitit 2004 - ku në fakt për herë të parë dhuna në familje është rregulluar në këtë sferë, janë vendosur disa masa individuale të mbrojtjes. Në këtë drejtim, Qendra e punëve sociale dhe organizatat joqeveritare që punojnë në sferën e çrënjosjes dhe parandalimit të dhunës në familje, kanë fituar mundësi ligjore për ndërtimin e sistemit të domosdoshëm koordinues të mbrojtjes. Përpos masave të parapara individuale në ligj, është dhënë mundësia të ndërmerren edhe të gjitha masat tjera që do të shërbejnë për realizim e mbrojtjes së viktimës.

3.2 LEGJISLACIONI RRETH ÇËSHTJEVE FAMILJARE

Në Ligjin për familje me dhunë në familje konsiderohet sjellja e një anëtarë të familjes, i cili me përdorimin e forcës, kanosjes së familjes, frikësimit kryen dëmtime fizike, keqpërdorim seksual apo emocional dhe keqpërdorim material, shfrytëzim seksual apo fizik ndaj ndonjë anëtarë tjetër të familjes.

Si dhunë në familje konsiderohet nëse me sjellje të tillë kryhet:

- nëse nga njeri bashkëshort ndaj tjetrit që jetojnë apo kanë jetuar në bashkësi martesore ose jashtë saj ose për çfarëdo lloj bashkësie si familje apo nëse kanë fëmijë të përbashkët;
- ndërmjet vëllezërve dhe motrave, vëllezër ose motra prej njërit prind;
- ndaj fëmijës;
- ndaj anëtarëve më të moshuar të familjes; dhe
- ndaj personave-anëtarë të familjes që kanë aftësi të kufizuara pjesërisht ose tërësisht³.

Ofrimi (sigurimi) i sigurisë dhe mbrojtja e viktimës nga dhuna e ardhshme, respektivisht ndihmë për tejkalimin e pasojave nga dhuna e përjetuar, si dhe krijimi i kushteve për integrimin e saj në mjedisin social janë kushtet themelore që duhet të plotësohen gjatë ndërmarrjes së masave për mbrojtje. Zakonisht, këto masa, përpos për viktimën, do të thotë ofrimi i mbrojtjes dhe sigurisë për anëtarët e familjes që paraqiten në rolin e viktimave sekundare.

² Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Neni 122, paragrafi 19, Gazeta Zyrtare 19/04

³ Ligji për familjet, Neni 99, Gazeta Zyrtare nr. 38/04

Vend qendror në Ligjin për familjen, sa i përket mbrojtjes nga dhuna në familje, u takon **Masave të përkohshme për mbrojtje** të viktimave të dhunës në familje, që kanë për qëllim mbrojtjen e drejtpërdrejt dhe të shpejt të viktimës. Në raste të shkeljeve serioze apo të incidenteve ne seri që kanë intensitet të lartë, masat e përkohshme për mbrojtje dhe ndjekja penale së bashku mund të arrijnë rezultate më efikase.

Në procesin e ndjekjes së mëtutjeshme të implementimit të zgjidhjeve ligjore, posaçërisht në pjesën e legjislacionit që ka të bëjë me familjen, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, shoqatat e qytetarëve që punojnë në këtë sferë dhe institucionet tjera relevante kanë identifikuar nevojën për ndryshime dhe plotësime të mëtutjeshme të Ligjit për familje. Në fakt, me ndryshimet të Ligjit për familje në vitin 2006, u përcaktua mandati i ministrive relevante në pjesën e kryerjes së masave të përkohshme për mbrojtje.

Përpos këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve, e me qëllim të implementimit të unifikuar dhe gjithëpërfshirës të Ligjit, si dhe për shkak të harmonizimit të standardeve ndërkombëtare në këtë sferë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në bashkëpunim me organizatat relevante të qytetarëve në vitin 2007 hartoi propozim për plotësime dhe ndryshime të Ligjit për familje.

Me ndryshimet dhe plotësimet e fundit sigurohet një harmonizimin i definicionit të dhunës në familje me Kodin Penal; mundësi e shoqatave të qytetarëve të sigurojnë masa për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje, obligim për lajmërim të të gjithë atyre që ndërmarrin veprime për mbrojtja nga dhuna në familje deri te qendra kompetente në afat prej 72 orëve. Njëherësh, me ndryshimet i jepet një mundësi shtesë viktimës, përpos formës indirekte nëpërmjet qendrës për punë sociale, me iniciativë personale të parashtrijë propozim deri te Gjykata për shqiptimin e masës së përkohshme për mbrojtje.

Në vitin 2007 për shkak të operacionalizimit të një pjese të zgjidhjeve ligjore nga Ligji për familje dhe për avancimin e rregullativës nënligjore u soll Rregullorja për mënyrën e zbatimit dhe ndjekjes së masave të

shqiptuara për mbrojtjen e familjes dhe personave viktimë të dhunës në familje të ndërmarrë nga Qendra për punë sociale dhe për mënyrën e ndjekjes së masave të përkohshme që i ka shqiptuar Gjykata.

3.3 MBROTJA SOCIALE

Reforma në mbrojtjen sociale e filluar në vitin 2004, me zhvillimin e parimit të pluralizmit jep mundësi për subjekte të ndryshme të paraqiten si ofruese të shërbimeve për qytetarët.

Në këtë drejtim, si forma të reja të mbrojtjes jashtë-institucionale, ndërmjet tjerash, është paraparë edhe Qendra e personave-viktima të dhunës në familje, e cila mund të themelohet si ent për mbrojtjen sociale apo si ndonjë pjesë organizative e ndonjë enti adekuat. Qendra e personave – viktimë të dhunës në familje siguron pranim ditor dhe të përkohshëm dhe përkujdesje për këta persona, trajtim ky që mund të zgjattë më së shumti gjashtë muaj me mundësi për vazhdim edhe për gjashtë muaj, ofrimi i shërbimeve këshilluese, shërbime në lidhje me ushqimin, qëndrim ditor, përkujdesje, mirëmbajtje të higjienës dhe aktivitete kulturo-artistike.

Në sistemin e mbrojtjes sociale u krijua baza që subjekte të ndryshme të paraqiten si ofrues të shërbimeve të caktuara nga mbrojtja sociale. Për herë të parë është dhënë mundësi që shoqatat e qytetarëve nga sfera e mbrojtjes sociale të regjistrohen në Regjistrin që e udhëheq Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, me qëllim që shërbime sociale të caktuara t'u delegohen me financim të pjesshëm nga ana e Ministrisë. Nga fushëveprimi i punëve të mbrojtjes sociale, e që kanë të bëjnë me dhunën në familje, ndonjë shoqatë të qytetarëve mund t'i ndahet ushtrimi i rolit social për pranim ditor dhe të përkohshëm dhe përkujdesje të shfrytëzuesve të mbrojtjes sociale për viktimë të dhunës në familje. Në tekstin e ri të Ligjit për mbrojtje dhe siguri sociale parashikohet që shoqatat e qytetarëve të mund t'i zbatojnë masat për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, në pajtim me ligjin për familjet.

PJESA E TRETË

3.4 DOKUMENTET E RATIFIKUARA NDËRKOMBËTARE

Statusi dhe pozita juridike e femrave në Republikën e Maqedonisë, përveç me Kushtetutë, është rregulluar edhe me marrëveshje ndërkombëtare që Republika e Maqedonisë i ka firmosur dhe i ka ratifikuar, të cilat, në pajtim me nenin 118 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë janë pjesë përbërëse e rregullimit tonë juridik.

Karakteristika themelore e sistemit kushtetues të Republikës së Maqedonisë është koncepti i saj qytetar, ky koncept bazohet në idenë për pavarësi dhe të drejta të individëve. Në pajtim me këtë, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë garanton një paket të gjerë të të drejtave dhe lirive të njeriut, si një ndër shtyllat themelore të sistemit politik demokratik; inter alia të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të pranuar me të drejtën ndërkombëtare, me vlera themelore të sistemit kushtetues marrëveshjet themelore të njeriut të Republikës së Maqedonisë.

Në sferën e rregullimit ndërkombëtar për ballafaqimin me dhunën në familje, është me rëndësi të madhe edhe miratimi i **Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrës të Kombeve të Bashkuara**⁴, e cila në mënyrë të tërësishme i elaboron çështjet kryesore për eliminimin e diskriminimit të femrës dhe parashikon qëllime dhe masa që shteti duhet t'i ndërmarrë për tejkalimin e saj. Ky dokument ndërkombëtar paraqet një instrument universal, dokument ky që parashikon masa gjithëpërfshirëse për promovimin e parimit të barazisë gjinore në jetën politike dhe publike, në arsim, në punësim dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës, në mbrojtjen shëndetësore dhe shëndetit, në jetën ekonomike dhe shoqërore, në barazinë para ligjit, në martesë dhe marrëdhëniet familjare, në arritjen, ndërrimin apo mbajtjen e nënshtetësisë, kurse rëndësi të veçantë i kushton edhe probleme të femrës në mjediset rurale.

Por, kur bëhet fjalë për çështjen e dhunës ndaj femrave, për fat të keq, Konventa nuk e rregullon këtë në mënyrë implicite. Për këtë shkak, në vitin 1992 Komiteti ka miratuar Rekomandimin 19 (Dhuna ndaj femrave), e cila në mënyrë eksplicite përcakton se ndalesa ndaj diskriminimit gjinor e përfshin edhe dhunën ndaj femrave. Në këtë Rekomandim është parashikuar obligimi që shtetet t'i ndërmarrin të gjitha masat e duhura për eliminimin e këtij lloji të dhunës, duke përfshirë edhe zgjidhje adekuate ligjor në legjislacionet ndëshkuese dhe qytetare, parandaluese (informim i publikut dhe fushatave edukative) dhe masa për mbrojtje (sigurimi i ndihmës dhe përkrahjes së viktimave).

Obligimi detyruar për respektimin e dispozitave të tyre dhe realizimi i standardeve që janë parashikuar në këtë rekomandim është personifikuar në mekanizmin e dhënies së llogarisë të shteteve, respektivisht parashtrimi i raporteve të rregullta deri te Komiteti për eliminimin e diskriminimit të femrës. Rëndësinë e Konventës e përforcon Protokollin fakultativ⁵, me çka mundësohet parashtrimi dhe shqyrtimi i padive të individëve dhe grupe të qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave të tyre nga ana e Komitetit. Sistemi i efikas juridik, mosekzistimi i zgjidhjeve ligjore si dhe procedura e gjatë e paarsyeshme për mbrojtje, janë përjashtimet nga rregulli i përgjithshëm, me çka për parashtrimin e këtij lloji të padisë deri te Komiteti i KB-ve fillimisht duhet të shfrytëzohen të gjitha zgjidhjet të parapara në legjislacionin e vendit.

Këtë lloj mbrojtjeje femrat mund ta kërkojnë edhe te seksionet tjera të KB-ve, respektivisht në Komisionin për statusin e femrave, te Raportuesi Special për dhunën ndaj femrës, te Komiteti për të drejtat e njeriut, te Komiteti kundër torturës.

⁴ Konventa është miratuar në vitin 1979, kurse ka hyrë në fuqi në vitin 1981. Përfundimisht me 2 nëntor këtë Konventë e kanë miratuar 185 shtete.

⁵ Protokollin fakultativ ka hyrë në fuqi në vitin 2000, dhe përfundimisht me 2 shkurt të vitit 2007 e kanë ratifikuar 85 shtete.

Republika e Maqedonisë për herë të parë parashtrori raport në lidhje me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrës në janar të vitit 2006. Në këtë sesion Republika e Maqedonisë e parashtrori dhe e prezantoi raportin e kombinuar inicial periodik të dytë dhe të tretë, që më pas pasuan sjelljet e rekomandimeve përfundimtare të Komitetit sa i përket të njëjtit.

Vlerësimi i progresit dhe përparimit në sferën e avancimit të pozitës së femrës dhe marrëdhëniet ndërmjet gjinive nga ana e Komitetit, të shndërruara në rekomandime përfundimtare, në fakt janë rekomandimet dhe prioritetet të cilave Republika e Maqedonisë duhet t'u kushtojë rëndësi dhe të ndërmarrë hapa serioz për tejkalimin e tyre. Në këtë drejtim, Komiteti, në sferën e dhunës në familje rekomandoi⁶:

Duke i përshëndetur masat e ndërmarra ligjore në luftën kundër dhunës ndaj femrës, përfshirë këtu edhe amendamentet e vitit 2004 të Ligjit për familje, me të cilin amendament dhuna në familje definohet si vepër e posaçme penale në Kodin Penal, Komiteti akoma është i brengosur, me çka i bën thirrje Republikës së Maqedonisë që t'u japë përbërësi aplikimit të masave gjithëpërfshirëse kundër të gjitha llojeve të dhunës ndaj femrave, duke përfshirë këtu edhe dhunën në familje, duke e definuar atë dhunë si formë të diskriminimit dhe shkelje e të drejtave të femrave me Konventë. Komiteti i bën thirrje shtetit, që në formë plotësuese ta elaborojë dhe ta zbatojë legjislationin për dhunën ndaj femrave, me qëllim që të sigurohet ndjekje efektive dhe sanksion të shkelësve dhe mbrojtje dhe ndihmë adekuate për viktimat.

Përpos dhënies llogari para Komitetit për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrës, e në lidhje me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrës, Republika e Maqedonisë parashtron raport edhe Raportuesit Special për dhunë ndaj femrave, Komitetit për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore dhe Komitetit kundër torturës.

Rëndësi të madhe në trajtimin e dhunës ndaj femrave është Deklarata për eliminimin e dhunës ndaj femrave⁷. Deklarata me këtë e demonstroi konsensusin e arritur në nivel ndërkombëtar, sipas së cilit, dhuna ndaj femrës, dhuna në familje, paraqet shkelje e të drejtave të femrave dhe e pamundëson dhe e kufizon gëzimin e tyre.

Platforma e Pekinit për aksion, Deklarata e Kuvendit të Përgjithshëm nga viti 2000, Programi për punë (2002-2006) i Komisionit për statusin e femrave, Deklarata e këtij Komisioni nga viti 2005, si dhe vendosja e lidhjes midis Platformës së Pekinit dhe Qëllimeve Zhvilluese të Mileniumit – paraqesin dokumentet (hapat) përmes të cilave organizata e KB-ve e konfirmojnë angazhimin e tyre të vazhdueshëm për ballafaqimin me këtë lloj të dhunës.

Për rëndësinë e këtij problemi dhe për nevojën e kuptimit të drejt të tij dhe për ndërtimin e strategjive për ballafaqim, flet mjaftueshëm përcaktimi i tij në shumë dokumente ndërkombëtare, jo vetëm në nivel global, por edhe në nivel rajonal (Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës). Midis tyre numërohen: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; Deklarata Evropiane Sociale; Konventa Evropiane kundër Torturës; Rekomandimi 1450 (2000) i Këshillit të Evropës, Rekomandimi 1582 (2002) i Këshillit të Evropës dhe Rekomandimi (2002) 5 i Këshillit të Evropës.

Për aktualitetin dhe nevojën për aksion të përbashkët të koordinuar i të gjithë institucioneve në këtë sferë, flet mjaft angazhimi i vazhdueshëm i organizatave ndërkombëtare për shkatërrimin dhe parandalimin e këtij fenomeni, si në nivel ndërkombëtar, po ashtu edhe në nivel nacional. Shembull për këtë lloj të aksionit janë, në fakt, edhe Ditët Ndërkombëtare të përkushtimit në luftën kundër dhunës ndaj femrave i Kombeve të Bashkuara dhe Fushata e Këshillit të Evropës.

⁶ Rekomandimet janë lidhur me gjendjet në këtë sferë për të cilat raportohet para Komitetit, respektisht ajo është gjendja faktike e përcaktuar përfundimisht me fundin e vitit 2004 dhe analiza e legjislationit pozitiv, përfundimisht me vitin 2004.

⁷ Deklarata është miratuar në vitin 1993, me Rezolutën e Kuvendit të Përgjithshëm të KB-ve.

PJESA E KATËRT

PJESA E KATËRT: VIZIONI, MISIONI, PARIMET THEMELORE UDHËHEQËSE TË STRATEGJISË PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

1. VIZIONI

Vizioni i kësaj strategjie është:

- Vendosja e sistemit gjithëpërfshirës dhe efikas në Republikën e Maqedonisë për mbrojtjen dhe parandalimin nga dhuna në familje.

2. MISIONI

Misioni i të gjithë aktorëve për veprim lidhur me dhunën në familje është që sjellja e kësaj Strategjie të mundësojë:

- Sigurimin e kushteve për realizim të vazhdueshëm dhe të suksesshëm të Strategjisë për mbrojtje nga dhuna në familje nga ana e të gjithë aktorëve relevantë (institucionet qeveritare dhe joqeveritare);
- Ruajtja e rezultateve të arritura nga Strategjia

3. VLERAT THEMELORE

Duke u nisur nga vlerat themelore për respekt ndaj njerëzve, marrja e përgjegjësisë për masat dhe rezultatet, ndërtimi i raporteve cilësore ndër-njerëzore nëpërmjet transparencës të hapur për sugjerime, e në të njëjtë kohë duke pasur parasysh përgatitjen për ndjekjen e gjendjes, si dhe ndërmarrjen e masave të nevojshme nëpërmjet analizës së mundësive reale, detektimi i problemeve, krijimi i zgjidhjeve, identifikimi i mungesave dhe nevojave, përparësitë dhe rreziqet, të gjithë aktorët relevantë marrin përgjegjësi të plotë gjatë implementimit të Strategjisë në koordinim me sektorin joqeveritar.

4. PARIMET UDHËHEQËSE

4.1 EFEKTIVITETI

- **Respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut** në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe konventat ndërkombëtare dhe planet për aksion;
- **Mbrojtje të njëjtë për të gjithë**, tejkalimi i stigmatizimit pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë nacionale, prejardhjen etnike dhe shoqërore;
- **Avancimi** i bashkëpunimit ndër-sektorial dhe ndërministror, bashkëpunimi me sektorin joqeveritar, i bazuar në parimet e transparencës dhe partneritetit
- **Avancimi dhe ruajtja e sistemit të mbrojtjes** nëpërmjet përforsimit të resurseve për mbrojtje të viktimave të dhunës në familje

4.2 EFIKASITETI

- **Ruajtja** e sistemit të mbrojtjes pa marrë parasysh ndryshimet politike apo shoqërore
- **Përmirësimi i mbrojtjes** - ndërmarrja e masave dhe aktiviteteve, që do të thotë ulje dhe eliminim i faktorëve të caktuar që kanë ndikim negativ në jetën familjare
- **Suksesi** - harmonizim i qëllimeve, prioritetëve dhe masave në sistemin e mbrojtjes
- **Konsekuenca** - sigurimi i koordinimit të gjithanshëm gjatë arritjes së rezultateve
- **Transparencë** gjatë implementimit të Strategjisë
- **Promovimi** i Strategjisë për ngritjen e mbrojtjes dhe ndihma e familjes që është pre e dhunës në familje

4.3 SFIDAT

Strategjia nacionale për mbrojtjen nga dhuna në familje ka të bëjë me tërë popullatën e Republikës së Maqedonisë pa marrë parasysh gjininë, moshën, përkatësinë politike apo religjione.

Në përgjithësi, përmirësimi i cilësisë së jetës dhe mirëqenies në shtet duhet të mundësojë ulje të të gjitha rreziqeve që mund të kontribuojnë për paraqitjen e dhunës në familje.

Korniza kohore për hartimin e planit aksionar dhe implementimi i aktiviteteve është prej vitit 2008-2011.

4.4 RREZIQET

Rreziqet që mund të shkaktojnë prolongim të aktiviteteve nga Strategjia janë:

- Koordinimi i pamjaftueshëm i aktorëve relevantë në zbatimin e masave të kësaj Strategjie;
- Mospërkrahja e aktiviteteve me buxhetet financiare adekuate;
- Mosrespektimi i kornizës kohore, e paraparë në planet aksionare.

4.5 PROBLMET AKTUALE

Dhuna në familje përfshinë përdorimin e forcës, kanosjes dhe frikësimit, si dhe keqpërdorimin emocional dhe seksual. Në Republikën e Maqedonisë me këtë strategji do të vazhdohet rruga e deritanishme e institucioneve të sistemit, ndërsa ky është menaxhim i rrënjosur me problemin e dhunës familjare, rrënimi i të gjitha barrierave lidhur me të njëjtin, si dhe vështrimin se në këtë nuk duhet të shikohet si në "punë private familjare", por si problem shoqëror, që kupton nevojë nga inkuadrimi i të gjithëve vepruesve relativ.

PJESA E PESTË

PJESA E PESTË: QËLLIMI KRYESOR STRATEGJIK I STRATEGJISË DHE QËLLIMEVE SPECIFIKE STRATEGJIKE, REZULTATE DHE AKTIVITETE

5.1 QËLLIM KRYESOR STRATEGJIK

Qëllimi kryesor strategjik i strategjisë Nacionale për mbrojtje nga dhuna familjare është zvogëlim i dukurisë së dhunës familjare dhe përmirësimi i kualitetit për siguri me masa të sistemit në sferat preventive, intervenim, edukim, ndjekje dhe koordinim me sektorët, për arsye veprimi efektiv dhe efikas për menaxhim me dhunën familjare me sigurim të qëndrimit të vetëm dhe hyrje.

Organizatat qytetare janë aktorë kryesorë dhe partnerë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për promovim dhe përparim të gjitha formave për mbrojtje nga dhuna familjare.

5.2 QËLLIMET E POSAÇME, REZULTATET DHE AKTIVITETET PËR REALIZIMIN E STRATEGJISË

Qëllim i veçantë 1

Vendosje dhe zhvillim të qasjes së koordinuar ndër-sektorial në mbrojtje të viktimave të dhunës familjare.

Rezultati 1.1. Vendosja e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve të institucioneve kompetente në nivel qendror dhe lokal.

Aktivitete

1.1.1. Përgatitja e protokollit të unifikuar për trajtim të institucioneve nga ana e grupit ndër resor.

1.1.2. Vendosje të pilotit lokal trupi Koordinues në Shkup për trajtim të koordinuar në raste të dhunës familjare dhe mbajtjes së takimeve të shpeshta.

Bartës: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe organizata qytetare.

Periudha e realizimit: 2008-2010.

Qëllimi i veçantë 2

Preventiva e dukurisë së dhunës familjare nëpërmjet procesit edukativo-arsimor.

Rezultati 2.1. Situata e vërtetuar faktike për përmbajtje arsimore të qëndrueshme, planet dhe programet, nga aspekti i të drejtave të fëmijëve për mësim të sigurt, zhvillim dhe mosdiskriminim.

Aktivitete

2.1.1. Zbatimi i analizës së përmbajtjeve arsimore, planeve dhe programeve.

2.1.2. Përgatitja e rekomandimeve deri te institucionet kompetente për ndryshim të përmbajtjes në pajtim me Konventën për të drejtat e fëmijëve në plan për zbatimin e saj.

Rezultati 2.2. Zmadhim sigurimi dhe mbrojtje nga dhuna në institucionet edukativo-arsimore.

Aktivitete

2.2.1. Përgatitje e studimit përfshirës për situatat në lidhje me dhunën mbi fëmijët në shkollat e Maqedonisë.

2.2.2. Përvetësimi i rekomandimeve dhe ndërtimi i tyre në plan aksionar për mbrojtjen e fëmijëve në shkollat në nivel të gjithë territorit të Maqedonisë.

Bartësit për r. 2.1. dhe 2.2.: Ministria e Arsimit dhe Shkencës; Byroja për zhvillim të arsimit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe organizatat qytetare, të cilët punojnë në përparimin e shëndetit dhe sigurimit të drejtave të fëmijëve në arsim dhe Ministria e Shëndetësisë.

Periudha e realizimit: 2008-2009.

Rezultati 2.3. Përbajtjet e ndryshuara arsimore të ndjeshme në procesin arsimor të cilët kanë të bëjnë me matricat me vlerë në raport me çështjet gjinore.

Aktivitetet

2.3.1. Zbatim i analizës të programeve arsimore në shkollat e mesme dhe fillore për matricat me vlerë për rregullimin e raporteve në kurorë dhe familje.

2.3.2. Formimi i trupit ekspert përbërë nga organizata profesionale, institute dhe qendra hulumtuese, në bashkëpunim me Byronë për zhvillimin e arsimit për përgatitje të përbajtjeve adekuata për të drejtat e fëmijëve dhe familjes.

2.3.3. Përvetësimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të propozuara në programin arsimor për shkolla fillore dhe të mesme, sa i përket çështjes së gjinive.

Bartës: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, institucionet akademike të cilët merren me studimin e gjinisë dhe çështjeve gjinore.

Periodha e realizimit: 2009-2010.

Rezultati 2.4. Përfaqësimi i vërtetuar i dhunës familjare mbi fëmijët dhe përfaqësimi i dhunës te të rinjtë e shkollave të mesme.

Aktivitetet

2.4.1. Zbatim i hulumtimeve për përfaqësimin e dhunës familjare mbi fëmijët.

2.4.2. Zbatim i hulumtimeve për përfaqësimin e dhunës te të rinjtë e shkollave të mesme.

2.4.3. Furnizimi dhe promovimi i rezultateve nga hulumtimi për të përfaqësuarit e dhunës në shkolla.

Bartës: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe organizata qytetare.

Periodha e realizimit: 2009-2010.

Rezultati 2.5. Rritja e informimit te të rinjtë (fillore, shkolla të mesme, rinia studentore, si dhe fëmijët të cilët nuk ndjekin shkollë) për njohje të dhunës në raportet prind-fëmijë, ndërmjet fëmijëve dhe dhunës ndërmjet partnerëve.

Aktivitetet

2.5.1. Hartimi i planit arsimor për ngritje të vetëdijes te nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme për format e dhunës dhe njohja e tyre me kohë.

2.5.2. Organizimi dhe realizimi i stërvitjeve për aftësim të arsimtarëve - mentorëve.

Periodha e realizimit: 2008.

2.5.3. Ndërtimi i përbajtjeve për preventivë prej çfarëdo lloji të dhunës në programet vjetore për punë në shkollat dhe më gjerë në bashkësitë.

2.5.4. Ndërtimi i përbajtjeve për preventivë nga dhuna në programet për punë në këshillat e prindërve në shkollat fillore dhe të mesme.

